



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d, të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 11, paragrafët 1, 2 dhe 4 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17, dhjetor 2012), nenit 33.2, shkronja a, dhe të nenit 34.1 shkronja d), të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 31.10.2018, merr këtë

### V E N D I M

- I. **MIRATOHET** Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Ujup (Mustafë) Salihut, Shefqet (Mustafë) Rexhepit dhe Kadri (Tahir) Isufit,
- II. Pronat e paluajtshme që do të këmbehen kanë këto karakteristika:
  1. Prona e paluajtshme në pronësi të PSH, "rrugë" Kuvendi Komunal Prishtinë, parcela kadastrale nr. 741-18, e evidentuar në certifikatën e pronës P-71914050-00741-18, ZK Matiçan, me
  2. Parcelat kadastrale numër 741-1, e evidentuar në certifikatën e pronës P-71914050-00741-1 dhe parcela kadastrale numër 741-15, e evidentuar në certifikatën e pronës P-71914050-741-15, në pronësi të Ujup (Mustafë) Salihut, parcela kadastrale numër 741-2, e evidentuar në certifikatën e pronës P-71914050-00741-2, në pronësi të Kadri (Tahir) Isufit dhe parcela kadastrale nr. 741-16, e evidentuar në certifikatën e pronës P-71914050-00741-16, në pronësi të Shefqet (Mustafë) Rexhepi, ZK Matiçan.
- III. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private.
- IV. Këmbimi i parcelave të tokës me pronarin e cekur në pikën II, është bërë pasi nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit Rregullues "Mati 1" Prishtinë, miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01, nr. 35-642, dt. 01.04.2010.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelave kadastrale që do të këmbehen.



- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastral të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Pjesë përbërëse e këtij propozimi është edhe skica gjeodezike.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-463/01-0263739/18, më 01.11.2018

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Agim Kuleta

